



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
K R Y E T A R I

Nr. 746 Prot.

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax: 042 232491

Tiranë, më 31.07.2015

U R D H Ë R  
Nr. 94, Datë 31.07.2015

**PËR EDUKIMIN E VAZHDUESHËM PROFESIONAL TË  
PUNONJËSVE**

Në mbështetje të nenit 39 të Ligjit nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH", Ligjit 152/2013 "Për Nëpunësin Civil" dhe nenit 6 të "Rregullores së Organizimit dhe Funkcionimit Administrativ të KLSH", për zhvillimin e kapaciteteve audituese, rritjen e kompetencave aftësive profesionale nëpërmjet edukimit të vijueshëm profesional në KLSH dhe me qëllim sigurimin e arritjen e objektivave për trajnimet,

**U R D H Ë R O J:**

1. Organizimin e trajnimeve përgjatë Muajit Gusht 2015, në KLSH sipas "Programit të Trajnimit" bashkëngjitur këtij Urdhri. Trajnimi ka si qëllim, thellimin dhe përditësimin e njohurive duke punuar në veçanti me : Manualin e Auditimit të Performancës, Auditimit të Përputhshmërisë, Auditimit Financiar, Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si dhe me Standardet e INTOSAI-t : ISSAI 1, 10, 100, 200,300 dhe 400.
2. Të gjithë audituesit dhe stafi i KLSH , në fund të periudhës së trajnimit (*1 Shtator '15*), në varësi të eksperiencës audituese, duhet të arrijnë në nivelet e poshtëshënuara:
  - a) mbi 10 vjet eksperiencë , jo më pak se 10-12 ditë trajnimi;
  - b) 5-10 vjet eksperiencë , jo më pak se 12-15 ditë trajnimi;
  - c) deri në 5 vjet eksperiencë, jo më pak se 15-20 ditë trajnimi.
3. Moszbatimi i këtij Urdhri, ngarkon punonjësin me përgjegjësi për mospërbushje të detyrave dhe ndaj tij/saj do të merren masa sipas parashikimeve të ligjit 152/2013 "Për Nëpunësin Civil".
4. Për periudhën në vijim, përgjatë 10 ditëshit të fundit të muajit Shtator dhe muajit Tetor 2015, i gjithë stafi do të testohet për njohuritë e marra në zbatim të Programit të Trajnimit sa më sipër.

5. Për organizimin, administrimin dhe ndjekjen Programit të Trajnimit ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit Profesional.
6. Për zbatimin e këtij Urdhri, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoret e Departamenteve, Drejtorive dhe Drejtori i Metodologjisë dhe Zhvillimit Profesional.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
  
**Bujar LESKAJ**

